

Ndihma juridike



Disa ide nga praktika

www.respublica.org.al

Vëzhgim 2023

Ky raport u përgatit në kuadër të projektit “Zgjerimi i Shërbimeve të Ndihmës Juridike për Gratë dhe Burrat në Shqipëri” financuar nga Austrian Development Cooperation dhe zbatuar nga UNDP në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë. Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të UNDP, Austrian Development Cooperation apo partnerëve vendas.

Botues: Qendra “Res Publica”

Blv. Gjergj Fishta, Nd. 24, H.3, Ap.7, Tiranë, Shqipëri

Autorë: Dr. Irena Dule, Dorian Matlija

Layout & Design: Expo Vision Albania

© Qendra “Res Publica”, Tiranë, 2023

Treguesi i lëndës

<i>I. Konteksti.....</i>	<i>5</i>
<i>II. Ndihma juridike e ofruar nga OJF-të mbetet e pazëvendësueshme</i>	<i>7</i>
<i>III. Përfituesit e ndihmës juridike përtej kategorive që përcakton ligji.....</i>	<i>12</i>
<i>IV. Format e ndihmës juridike dhe problematika e aplikimit të secilës</i>	<i>16</i>
<i>V. Ndihma juridike dhe pengesat burokratike</i>	<i>19</i>
<i>VI. Problematika të tjera që rezultojnë nga praktika</i>	<i>21</i>
<i>VII. Rekomandime</i>	<i>23</i>

Ndihmë juridike falas

DISA IDE NGA PRAKTIKA



I. Konteksti

Garantimi i ndihmës juridike, sidomos në çështjet civile dhe administrative, është një instrument i rëndësishëm për mbrojtjen dhe fuqizimin e shtresave në nevojë dhe e grupeve të tjera të marginalizuara, në garantimin e aksesit në drejtësi, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe forcimin e shtetit të së drejtës. Ndihma juridike falas u lehtëson mbrojtjen e të drejtave qytetarëve, si dhe kontribuon në rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Për të rritur efencën dhe produktivitetin e ndihmës juridike, si dhe për të garantuar cilësinë e saj, është i domosdoshëm bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare, klinika ligji dhe me organizata jofitimprurëse vendase dhe të huaja në zhvillimin e sistemit të ndihmës juridike, si dhe zgjerimi/shtimi i kapaciteteve ofruese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Ligji 111/2017 “Për ndihmën juridike shtetërore”, i cili ka hyrë në fuqi në Qershor 2018, erdhi si nevojë e rregullimit ligjor për të realizuar dhënien cilësore të shërbimeve juridike falas në Shqipëri, me qëllim që qytetarët të realizojnë efektivisht të drejtat e tyre.

Më parë kjo fushë rregullohej nga ligji nr. 10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”. Ligji i ri, nr. 111/2017 “Për ndihmë juridike të garantuar nga shteti”, synon rritjen e efikasitetit në dhënien e ndihmës juridike. Disa risi të këtij ligji prezantohen në disa drejtime kryesore si p.sh. rritja e njësive për dhënien e ndihmës juridike parësore, rritja e vizibilitetit të dhënies së ndihmës juridike, si dhe procedura për marrjen e ndihmës juridike dytësore.

Në kuadër të projektit, “Zgjerimi i shërbimeve të Ndhmës Juridike për Gratë dhe Burrat në Shqipëri”, me financimin e Austrian Development Cooperation dhe zbatuar nga UNDP në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë, në një periudhë efektive 8 mujore, Qendra Res Publika ofroi ndihmë juridike. Gjatë projektit rezultuan disa gjetje të cilat do të trajtohen në vijim, së bashku me rekomandimet përkatëse.

II. Ndihma juridike e ofruar nga OJF mbetet e pazëvendësueshme

Ligji për Ndhmën Juridike parashikon se kjo ndihmë ofrohet nga:

1. Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore;
2. Klinikat e ligjit pranë institucioneve të arsimit të lartë;
3. Organizatat jofitimprurëse.

Nga të dhënat që gjenden të publikuara në faqen e Ministrisë së Drejtësisë (ndihmajuridike.gov.al) rezultojnë se aktualisht në vend operojnë rreth 36 njësi të renditura në vijim, të cilat ofrojnë ndihmë juridike parësore dhe në raste të veçanta këto qendra ofrojnë ndihmë juridike dytësore. Duhet sqaruar se në grupin e organizatave jofitimprurëse renditen ato organizata që janë të lidhura me një autorizim nga Ministria për ofrimin e ndihmës juridike, ndërsa ofrojnë ndihmë juridike edhe organizata të tjera në bazë të projekteve të ndryshme në kohëzgjatje të kufizuar. Këto të fundit nuk janë pjesë e listës më poshtë pasi mungon një databazë e tyre.

Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore

Tiranë:	<i>Ministria e Drejtësisë, Bulevardi “Zogu 1”</i>
Durrës:	<i>Rruga “Aleksandër Goga”, pranë Gjykatës së Rrethit</i>
Lushnje:	<i>Rr. “Bajram Haxhiu” pranë Bashkisë</i>
Pogradec:	<i>Pranë Bibliotekës Mitrush Kuteli</i>
Gjirokastrë:	<i>Në ambientet e ADISA</i>
Lezhë:	<i>Sheshi “Gjergj Kastrioti”, pranë Bashkisë</i>
Shkodër:	<i>Rruga “Don Bosko”, pranë Gjykatës së Rrethit</i>
Fier:	<i>Rruga “Ramiz Aranitasi”, pranë ADISA</i>
Dibër:	<i>Rruga “Avdyl Frashëri”, pranë Gjykatës së Rrethit</i>
Vlorë:	<i>Sheshi “4 Heronjtë”, pranë Bashkisë</i>



Organizatat jofitimprurëse të autorizuara

Tiranë:	Albanian Legal And Territorial Research Institute <i>Rr. "Asim Zeneli", Tiranë</i> Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (CRCA) <i>Rr. "Perlat Rexhepi", 18, Tiranë</i> Qendra Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza <i>Rr. "Muhamed Gjollesha" Tiranë</i> Qendra për Nisma Ligjore Qytetare <i>Rr. "Vaso Pasha", Tiranë</i> Qendra e Shërbimeve dhe Praktika Ligjore të Integruara <i>Blv. Gjergj Fishta", Tiranë</i> Qendra të Ndryshëm dhe të Barabartë <i>Rr. "Fortuzi", Tiranë</i> Qendra Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) <i>Blv. "Bajram Curri", Tiranë</i> Shoqata Shërbimet Shqiptare për Refugjatët e Migrantët <i>Sheshi "Karl Topia", Tiranë</i> Organizata "Refleksione" <i>"Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin", Tiranë</i>
Shkodër:	Qendra e Gruas Hapa të Lehtë <i>Rr. e Murgeshave", Shkodër</i>
Durrës:	Qendra Konsumatori Shqiptar <i>Lagjia nr. 11, P. 1319, Durrës</i>
Elbasan:	Forumi i Gruas Elbasan <i>Lagjia 5 Maji, Elbasan</i>
Berat:	Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Qytetare e Fshatare <i>Lagjia "30 vjetori", Berat</i>
Vlorë:	Qendra psiko-sociale Vatra <i>Lagjia "Isa Boletini", Vlorë</i>

Klinikat e ligjit pranë institucioneve të arsimit të lartë

Tiranë:	<i>Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës</i> <i>Universiteti Evropian i Tiranës</i> <i>Universiteti “Bedër”</i> <i>Kolegji Universitar “Wisdom”</i> <i>Universiteti “Luarasi”</i> <i>Universiteti “Qiriazi”</i> <i>Universiteti “Marin Barleti”</i> <i>Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë</i>
Shkodër:	<i>Universiteti “Luigj Gurakuqi”</i>
Durrës:	<i>Universiteti “Aleksandër Mojsiu”</i>
Vlorë:	<i>Universiteti “Ismail Qemali”</i>

Këto njësi shërbimi e kryejnë aktivitetin në seli të ndryshme, diku pranë Bashkive, diku në selitë e organizatave. Vetëm në 3 raste ky shërbim ofrohet pranë gjykatave. Ndërsa nga shtrirja territoriale, 50% e këtyre zyrave veprojnë në Tiranë. Ofrimi i këtij shërbimi kryesisht në qytetin e Tiranës është i justifikueshëm nëse konsiderohet që rreth 1/3 e popullsisë jeton në këtë bashki dhe njëkohësisht ajo është qendra e institucioneve kryesore në vend. Sipas të dhënave të INSTAT për vitin 2022 popullsia në vend është 2.793.592 banorë, nga të cilët 923.000 banorë jetojnë në Bashkinë Tiranë.

Gjithashtu rezulton se ndihma juridike jepet në 10 Qendra të Ndhmës Juridike Parësore, që ofrohen nga Drejtoria e Ndhmës Juridike pranë Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa në pjesën më të madhe në 26 qendra, kjo ndihmë ofrohet nga Klinikat e ligjit dhe organizatat jofitimprurëse.

Qendra Res Publica, nëpërmjet avokatëve të saj, ofroi ndihmë juridike parësore në mbi 300 raste dhe ndihmë dytësore në tre raste me rëndësi strategjike, në një kohë të kufizuar prej vetëm 8 muajsh, në ambientet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Veprimatria e zyrës u zhvillua në kuadër të projektit të cituar më sipër, pra nuk është pjesë e ndihmës së ofruar nga lista e mësipërme.

Gjatë periudhës së ofrimit të këti shërbimi u vu re se pjesë me e madhe e qytetarëve që i drejtoheshin zyrës për ndihmë juridike ishin subjekte që përfshihen në kategoritë që ligji për ndihmën juridike iu mundëson përfitimin e kësaj ndihme nga shteti, dhe që si rregull mund të aplikojnë për ndihmë në qendrat shtetërore. Arsytet pse këta individë i drejtoheshin kësaj zyre dhe jo njësive shtetërore për ofrimin e ndihmës janë disa:

Logjistika e favorshme: Vendodhja e zyrës pranë gjykatës ishte më e volitshme për qytetarët, pasi shërbimi ofrohej më afër organit nga i cili do të kërkonin zgjidhje sipas perceptimit të tyre.

Zero burokraci: Mungesa e burokracive që shoqëron një aplikim në zyrat e shtetit është një arsye e referuar shpesh në intervista me këta qytetarë

Pak besim te administrata shtetërore: Organet e administrarës shtetërore perceptoheshin si ofrues pak të besueshëm të shërbimit të ndihmës juridike këto qendra.

Për arsyet e mësipërme, ofrimi i kësaj ndihme nga organizata të shoqërisë civile duket të jetë i pakonkurueshëm në këtë aspekt.

III. Përfituesit e ndihmës juridike përtej kategorive që përcakton ligji

Kategoritë që përfshihen në skemën e ndihmës juridike falas nga shteti janë grupe vulnerabël në një mënyrë ose tjetër dhe kjo i ekspozon ata ndaj cënimit të të drejtave të tyre themelore. Shumë prej tyre janë kategori që i përkasin minoritetit rom ose egjiptian, persona me aftësi të kufizuara, viktimat të dhunës në familje etj. Ndodh shpesh që këta persona të jenë edhe në një situatë të vështirë ekonomike, gjë që i pengon ata të aksesojnë shërbime juridike me pagesë. Si rezultat, ata nuk trajtojnë problemet e tyre ligjore në institucionet përkatëse. Për më tepër, këta persona shpesh kanë njohuri më të kufizuara për ligjin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë sesa kategoritë e tjera, gjë që i bën ata të paaftë për të perceptuar fillimisht e më pas për të kërkuar e gëzuar të drejtat e tyre.

Ndihma juridike falas është shërbimi që garantohet dhe financohet nga shteti për të gjithë individët, pjesë e kategorive vulnerabël dhe/ose me të ardhura të pamjaftueshme, të cilët nuk kanë mundësi t'i drejtohen një avokati apo dhe juristi për zgjidhjen e problematikave të tyre ligjore. Ligji përcakton 2 kategori kryesore si subjekte përfitues të ndihmës juridike të garantuar nga shteti:

1. Subjektet me të ardhura të pamjaftueshme, dhe;
2. Kategoritë e shtresave të vecanta.

Subjekte me të ardhura të pamjaftueshme

Të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e ka çdokush që provon se ka të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet për këshillim, përfaqësim dhe/ose mbrojtje në çështjet penale, në çështjet administrative dhe në çështjet civile.

Të ardhurat e një personi, i cili jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, për efekt të përfitimit të ndihmës juridike, nëse të ardhurat në total të të gjithë pjesëtarëve të familjes, të pjesëtuara për numrin e anëtarëve të familjes, janë më të ulëta se 50 për qind e pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

Të ardhurat e një personi, i cili nuk jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

Nëse një person, i cili jeton në një familje, kërkon ndihmë juridike dytësore për një çështje kundër një anëtari tjetër të së njëjtës familje, të ardhurat e këtij personi konsiderohen të pamjaftueshme, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

Pasuria e një personi konsiderohet e pamjaftueshme, nëse vlera e saj nuk tejkalon vlerën e 36 pagave minimale mujore sipas legjislacionit në fuqi.

Kategoritë e veçanta

Kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike janë subjektet e mëposhtëm, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre:

- a) viktimave të dhunës në familje;
- b) viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të genieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;
- c) viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;

- c) fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- d) fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
- dh) personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;
- e) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor;
- ë) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore;
- f) personave, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi;
- g) personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitimin e zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;
- gj) personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;
- h) personave, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Gjatë ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike nga Qendra Res Publica u vu re se përvec grupeve të mësipërme, një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve që i janë drejtuar zyrës janë persona në pamundësi serioze financiare, por që nuk plotësojnë kërkesat ligjore për ta përfituar atë nga shteti. Vihet re se ligji nuk ofron mbështetje qoftë edhe të pjesshme, në proporcion me të ardhurat e tyre, për të paktën individët që kanë të ardhura pak mbi limitin e përcaktuar nga ligji. Gjithsesi këta individë mbeten në nevojë për përfitimin e kësaj ndihme. Këta persona, të vetmen alternativë kanë përfitimin e ndihmës juridike nga organizata të specializuara të shoqërisë civile.

Vihet re se nevojë për ndihmë juridike kanë edhe shoqatat që përfaqësojnë kategoritë e mësipërme, të cilën si të vetmen mundësi përfitimi të kësaj ndihme kanë organizata të tjera që e ofrojnë këtë shërbim. Si shembull mund të japim ofrimin e ndihmës juridike dytësore nga Qendra Res Publika në përfaqësimin në çështjen gjyqësore të Shoqatës Humanitare të Para dhe Tetraplegjikëve të Shqipërisë, e cila pati mundësinë të siguronte përmes një vendimi gjyqësor, të ekzekutueshëm menjëherë, të një ambienti të aksesueshëm për të ushtruar veprimtarinë e tyre nga Bashkia Tiranë. Çështja është në pritje të gjyqimit në Gjykatën Administrative të Apelit dhe do të ndiqet përtej përfundimit të projektit, gjë që evidenton edhe nevojën për mbështetje më afatgjatë të çështjeve gjyqësore.

Një tjetër organizatë komunitare, e cila është ndihmuar edhe më herët nga Qendra Res Publica është Shoqata e Familjarëve të Viktimave të Shpërthimit të Gërdecit, e cila pati mundësinë të adresojë kërkesat e saj për një hetim dhe gjykim më të plotë të tragjedisë së Gërdecit.

IV. Format e ndihmës juridike dhe problematika e aplikimit të secilës

Ligji e ndan ndihmën juridike në tre forma:

1. Ndhmë juridike parësore;
2. Ndhmë juridike dytësore;
3. Përgjashtimi nga tarifat dhe shpenzimet gjyqesore.

Ndhma juridike parësore realizohet përmes këtyre shërbimeve:

1. Dhënien e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;
2. Dhënien e këshillimit;
3. Dhënien e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve;
4. Dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratë shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;
5. Përfaqësimin përpara organeve administrative;
6. Dhënien e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

Kjo formë ofrohet edhe nga organizata të shoqërisë civile. Është vënë re nevoja e ofrimit të kësaj ndihme brenda gjykatave, kryesisht të shkallës së parë, aty ku perceptohet se gjendet zgjidhja e problemeve/konflikteve. Kjo rezulton nga numri i lartë i kërkesve edhe gjatë veprimtarisë së zyrës së ofrimit të ndihmës juridike gjatë këtij projekti, por edhe nga biseda me stafin e administratës së gjykatës, të cilët shprehen të shqetësuar nga mbyllja e projektit dhe për rrjedhojë edhe të zyrës, pikërisht kur kishte nisur të rritej fluksi i kërkesve.

Ndihma juridike dytësore është ai lloj shërbimi juridik që ofrohet për problematikat zgjidhja e të cilave mund të realizohet vetëm nëpërmjet gjykatës apo prokurorisë. Kjo lloj ndihme ofrohet nga avokatët e licencuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Personi, me anë të avokatit falas, i drejtohet gjykatës apo prokurorisë për zgjidhjen e çështjeve apo problematikave të çdo fushe (civile, penale, administrative).

Edhe kjo lloj ndihme ofrohet, si nga skema shtetërore e ofrimit përmes avokatëve të caktuar nga Gjykata, ashtu edhe nga shërbimet e ofruara nga organizata jofitimprurëse të mbështetura nga grante. Është vënë re se një proces gjyqësor zgjat shumë më tepër se sa zgjat një projekt dhe nevoja për mbështetje juridike do të duhet të ketë vazhdimësi edhe pas mbylljes së një projekti.

Për ta ilustruar, gjatë projektit, Qendra Res Publica ofroi ndihmë juridike dytësore në një çështje gjyqësore kundër Bashkisë Tiranë, e cila u mbyll në gjykimin në shkallë të parë me sukses, por vendimi kërkon kohë dhe procedura vijuese për t'u ekzekutuar, edhe pse Gjykata e dha vendimin me ekzekutim të përkohshëm. Gjatë fazës së ekzekutimit, ekziston përsëri nevoja e përfaqësimit të shoqatës jashtë dhe brenda proceseve gjyqësore, për përmbushjen e kërkesave procedurale të nevojshme në fazën e ekzekutimit. Në të njëjtën mënyrë nevoja për shtrirje të mbështetjes evidentohet edhe në çështjen e mbrojtjes së interesave dhe të drejtave të familjarëve të viktimave të shërthimit të Gërdecit, çështje e nisur që në vitin 2008 dhe që është ende në proces. Çështja u ndoq nga Qendra Res Publica në një kohëzgjatje të konsiderueshme pa mbështetje financiare, dhe në pjesë të shkurtër kohe me mbështetje nga donatorë. Siç mund të kuptohet nevoja për mbështetje edhe e kësaj çështje i tejkalon afatet e një

projekti disa mujor ose 1 apo 2 vjeçar. Në këtë kontekst është e nevojshme që mbështetja e shërbimeve të ndihmës juridike të shtrihet në një kohëzgjatje më të madhe.

Kjo nevojë vihet re edhe në formën e ndihmës juridike parësore, ku një qytetar për ndjekjen e një çështje ka nevojë të marrë këshillime më shumë se një herë në një kohëzgjatje më të madhe, për shkak të burokracisë që shoqëron zgjidhjen e një çështjeje si brenda dhe jashtë gjyqësorit. Edhe më e rëndësishme është kjo, nëse kemi parasysh kohëzgjatjen në mënyrë të jashtëzakonshme në kuadër të efekteve anësore të reformës në drejtësi, për shkak të vonesave në gjyqësor, si pasojë e procesit të vettingut.

Përrjashtimi nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.

Personat, të cilët kanë të drejtën për të marrë ndihmë juridike dytësore sipas kategorive trajtuar më sipër gëzojnë të drejtën për përrjashtim nga:

- a) Pagimi i tarifave të përrgjithshme dhe të veçanta, sipas përrcaktimeve të ligjit për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë;
- b) Pagimi i shpenzimeve gjyqësore (shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët, përrkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend), sipas përrcaktimeve të legjislacionit procedural;
- c) Detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrat të ekzekutimit pranë shërbimit përrmbarimor gjyqësor shtetëror.

Kjo lloj ndihme ofrohet në përrgjithësi përrmes skemës së mbështetur nga shteti. Rrallë vihet re se ky lloj shërbimi është ofruar nga organizatat jofitimprurëse. Vlen të theksohet se shpenzimet gjyqësore dhe tarifat janë pjesë e domosdoshme e një procesi gjyqësor dhe pamundësia e këtyre pagesave e bën të pamundur aksesin në gjykatë, për këtë arsye, rekomandohet mbështetja, qoftë edhe pjesërisht, e kësaj lloj ndihme nga donatorë të investuar në këtë fushë.

V. Ndihma juridike dhe pengesat burokratike

Procedura për përfitimin e ndihmës juridike të ofruar nga shteti nis me paraqitjen personalisht pranë njësive të dhënies së shërbimit juridik falas, të individit që kërkon ndihmën duke paraqitur një mjet identifikimi si dhe dokumenta të cilët justifikojnë dhënien e kësaj ndihme sipas kategorisë të trajtuar më sipër, që individi i përket. Më konkretisht, këto dokumenta lidhen me vërtetimin se subjekti është kategori e veçantë ose subjekt në pamundësi financiare për të përballuar një avokat ose jurist. Këto dokumenta në varësi të rasteve mund të jenë, por pa u kufizuar:

- Vërtetim papunësie
- Vërtetim trajtimi me ndihmë ekonomike
- Vërtetim trajtimi me KEMP (paaftësi mendore/fizike)
- Vërtetim mbi pasuritë e paluajshme që disponon
- Vërtetim page bruto dhe neto
- Vërtetim nga sigurimet shoqërore në rast të pagesës që kryhet prej këtyre institucioneve sikurse mund të jetë pensioni i pleqërisë.

Në çdo rast, ky shërbim shoqërohet nga plotësimi i formularëve kërkesës dhe vetëdeklarimit për ndihmën dytësore dhe/ose parësore.

Nëse kërkesa është për dhënien e ndihmës dytësore, me plotësimin e formularëve për dhënien e një avokati të garantuar nga shteti, procedura është pak më e ndërlikuar. Këtu nuk mjafton plotësimi i formularëve në mënyrë mekanike, por mbi të gjitha punonjësi me trajnim të posaçëm duhet dhe të realizojnë një vlerësim paraprak të dokumentacionit përkatës të çështjes ligjore, nëpërmjet të cilave kupton nëse qytetari ka një çështje për të ngritur në gjykatë ose jo. Pasi realizohet ky hap i pare i rëndësishëm, faza tjetër është ajo e plotësimit të kërkesës për ndihmë dytësore nëpërmjet formularëve përkatës, që i lidhet dokumentacioni provues, të cilët depozitohen pranë gjykatës së juridiksionit fillestar ku do të ngrihet çështja në themel. Nëse gjykata pranon dhënien e një avokati të garantuar nga shteti, një kopje e vendimit të gjykatës i dërgohet Dhomës së Avokatisë së Rrethit përkatës, një kopje Drejtorisë për Ndihmën Juridike falas dhe një kopje qytetarit kërkues. Avokati do të caktohet nga lista e administruar nga Dhoma Vendore e Avokatisë.

Duke u nisur nga kërkesat e ligjit janë përcaktuar në mënyrë të saktë dhe të qartë kriteret dhe metodologjia për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes. Nga ana tjetër kërkesat e ligjit për plotësimin e formularëve, dokumentave justifikues, procesverbalet, skedat, raportet narrative dhe raportet e të dhënave, përveçse standardizojnë mënyrën e ofrimit të shërbimeve dhe kontrollit të cilësisë së tyre, në shumë raste krijojnë edhe problematika, ngërçe, vonesa dhe burokraci, duke ndikuar në ritmin e ofrimit të shërbimeve juridike falas. Në këtë aspekt, organizatat e shoqërisë civile janë më fleksibël në ofrimin e kësaj ndihme, pikërisht për shkak të mungesës së burokracisë. Ndaj, rritja e mbështetjes së këtij lloj shërbimi nga organizatat jofitimprurëse është i domosdoshëm, edhe për këtë arsye.

VI. Problematika të tjera që rezultojnë nga praktika

Tërheqja e fondeve për avokatë cilësorë

Ofrimi i ndihmës juridike parësore nuk mer parasysh kompleksitetin e një çështjeje. Njësoj nuk merret parasysh faza e ekzekutimit, proces i lidhur domosdoshmërisht me gjykimin e një çështje dhe që shpesh herë ka kompleksitetin e vet.

Në këtë kuptim një avokat pa përvojë dhe jo i afirmuar e ka të vështirë të ndjekë me cilësi çështje të kësaj natyre. Ndërsa nxitja e avokatëve me eksperiencë mungon për shkak të pagesave. Pagesat për avokatët që ofrojnë ndihmë juridike falas janë në nivele të ulëta krahasuar me tregun. Nga ana tjetër në rastet kur ndihma juridike falas mbulohet me fonde nga donatorët (dhe jo nga shteti) pagesa e këtyre avokatëve është më e lartë, gjë që e bën më efektive ofrimin e këtij shërbimi nga avokatët e kontraktuar nga organizata të shoqërisë civile.

Ndergjegjësimi dhe promovimi për ekzistencën e ndihmës juridike dhe nxitjen dhe mungesën e stigmatizimit

Një moment mjaft i rëndësishëm për përmbushjen e qëllimit të shërbimit juridik falas do të ishte dhe organizimi i fushatave për rritjen e

ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përftimin e saj. Kjo do të thotë që si qëllim parësor nuk duhet të jetë vetëm e drejta e qytetarit për ndihmë juridike, por edhe informimi i asaj pjese të shoqërisë që nuk e ka këtë informacion, ti garantohet komunikimi për këtë të drejtë thelbësore. Ndihma juridike duhet të ofrohet jo vetëm me kërkesën e qytetarit por duhet përcjellë edhe nëpërmjet edukimit ligjor të publikut.

Gjithashtu është vënë re se mungon kultura juridike për të qenë të sigurtë me avokatin, që vjen edhe për shkak të stigmës. Në këtë kuptim, nevoja e edukimit juridik në nivel bazik pjesë e kurikulave shkollore që në arsimin parauniversitar.

VII. Rekomandime

Rekomandim nr. 1

Ofrimi i ndihmës juridike nga organizatat e shoqërisë civile duket të shihet si i pakonkurueshëm nga ofrimi i ndihmës juridike nga skema shtetërore. Vihet re se subjektet që përfshihen në kategoritë që ligji për ndihmën juridike iu mundëson përfitimin e kësaj ndihme nga shteti, nuk i drejtohen qendrave shtetërore por zyrave të ofrimit të kësaj ndihme, siç ishte rasti i testuar nga Res Publica për një periudhë 8 mujore. Kjo vjen për disa arsye që lidhen me:

- a. Vendodhjen e zyrës pranë gjykatës, që do të thotë më afër organit nga i cili do të kërkonin zgjidhje sipas perceptimit të tyre;
- b. Mungesën e burokracive që shoqëron një aplikim në zyrat e shtetit;
- c. Mungesën e besimit të qytetarit te organet e administratës publike, siç perceptohen shpesh shërbimet shtetërore;
- d. Ofrimi i ndihmës juridike parësore sipas skemës shtetërore nuk mer parasysh kompleksitetin e një çështjeje. Njësoj nuk merret parasysh faza e ekzekutimit, proces i lidhur domosdoshmërisht me gjykimin e një çështjeje dhe që shpesh herë ka kompleksitetin

e vet. Në këtë kuptim një avokat pa përvojë dhe jo i afirmuar e ka të vështirë të ndjekë me cilësi çështje të kësaj natyre. Ndërsa nxitja e avokatëve me eksperiencë mungon për shkak të pagesave të ulëta. Nga ana tjetër në rastet kur ndihma juridike falas mbulohet me fonde nga donatorët (dhe jo nga shteti) pagesa e këtyre avokatëve është më e lartë, gjë që e bën më efektiv ofrimin e këtij shërbimi nga avokatët e kontraktuar nga organizata të shoqërisë civile.

Rekomandim nr. 2

Gjatë ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike nga Qendra Res Publica u vu re se përveç grupeve të mësipërme, një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve që i janë drejtuar zyrës janë persona në pamundësi financiare të ndjeshme, por që nuk plotësojnë kërkesat ligjore për ta përfituar atë nga shteti. Vihet re se ligji nuk ofron mbështetje qoftë edhe të pjesshme, në proporcion me të ardhurat e tyre, për të paktën individët që kanë të ardhura pak mbi limitin e përcaktuar nga ligji. Gjithsesi këta individë mbeten në nevojë për përfitimin e kësaj ndihme. Këta persona, të vetmen alternativë kanë përfitimin e ndihmës juridike nga organizata të shoqërisë civile.

Rekomandim nr. 3

Vihet re se nevojë për ndihmë juridike kanë edhe vetë shoqatat që përfaqësojnë kategoritë e subjekteve që kanë nevojë për ndihmë juridike falas, të cilën si të vetmen mundësi përfitimi të saj kanë organizata të tjera ligjore që e ofrojnë këtë shërbim. Një pjesë e rëndësishme e advokimit nga këto shoqata është edhe ndjekja e proceseve gjyqësore për interesa të komunitetit që ato përfaqësojnë.

Rekomandim nr. 4

Ndihma juridike parësore ofrohet si nga skema shtetërore e ofrimit përmes avokatëve të caktuar nga gjykata edhe nga shërbimet e ofruara nga organizata jofitimprurëse, të mbështetur nga projekte të caktuara.

Është vënë re se një proces gjyqësor zgjat shumë më tepër se sa zgjat një projekt dhe nevoja për mbështetje ligjore do të duhet të ketë mbështetje edhe pas mbylljes së një projekti. Në këtë kontekst është e nevojshme që mbështetje e shërbimeve të ndihmës juridike të shtrihen në një kohëzgjatje më të madhe. Kjo nevojë vihet re edhe në formën e ndihmës juridike parësore, ku një qytetar për ndjekjen e një çështjeje ka nevojë të marrë këshillime më shumë se një herë në një kohëzgjatje më të madhe, për shkak të burokracisë që shoqëron zgjidhjen e një çështjeje, si brenda, ashtu edhe jashtë gjyqësorit. Edhe më e rëndësishme është kjo, nëse kemi parasysh kohëzgjatjen në mënyrë të jashtëzakonshme në kuadër të efekteve të ardhura për shkak të vonesave në gjyqësor, si pasojë e procesit të vettingut. Këto efekte pritet të zgjasin për një dekadë.

Rekomandimi nr. 5

Përrjashtimi nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore është një nga format e ndihmës juridike falas. Kjo ndihmë ofrohet në përgjithësi përmes skemës së mbështetur nga shteti. Rrallë vihet re se ky lloj shërbimi ofrohet nga organizatat jofitimprurëse. Vlen të theksohet se shpenzimet gjyqësore dhe tarifat janë pjesë e domosdoshme e një procesi gjyqësor dhe pamundësia e pagimit të tyre e bën të pamundur aksesin në gjykatë. Për këtë arsye rekomandohet mbështetja e kësaj lloji ndihme nga donatorët.

Rekomandimi nr. 6

Një moment mjaft i rëndësishëm për përmbushjen e qëllimit të shërbimit të ndihmës juridike falas është dhe organizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimi publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përftimin e saj. Kjo do të thotë që si qëllim parësor nuk duhet të jetë vetëm e drejta e qytetarit për ndihmë juridike, por edhe informimi i asaj pjese të shoqërisë që nuk e ka këtë informacion, ti garantohet komunikimi për këtë të drejtë thelbësore. Ndihma juridike duhet të ofrohet jo vetëm me kërkesën e qytetarit por duhet përcjellë edhe nëpërmjet edukimit ligjor të publikut. Gjithashtu vihet re se mungon kultura juridike për të qenë të sinqerte me avokatin, që vjen edhe për shkak të stigmës. Në këtë kuptim, shihet e nevojshme që edukimi juridik në nivel bazik të bëhet pjesë e kurikulave të arsimit të mesëm.

Rekomandimi nr. 7

Shërbimet juridike pro bono janë një mundësi e mirë për të përfshirë avokatë që vullnetarisht ofrojnë kohën dhe ekspertizën e tyre për të siguruar ndihmë juridike falas. Programet pro bono mund të luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e aksesit në drejtësi dhe në përmirësimin e sistemit të ndihmës juridike në përgjithësi. Këtu janë disa aspekte kyçe për tu konsideruar:

- a. Bashkëpunimi me Dhomën e Avokatëve dhe zyra të njohura avokatore
- b. Dhënia e çmimeve e stimujve moralë për avokatët që ofrojnë ndihmë pro bono
- c. Mentorim dhe Trajnim nga avokatë të specializuar
- d. Partneritetet me organizatat e shoqërisë civile

Programet pro bono luajnë një rol kryesor në përmirësimin e aksesit në drejtësi në procedurat penale, civile e administrative pasi shpërndajnë bazën e shërbimeve juridike të disponueshme për ata që nuk mund të paguajnë për përfaqësimin ligjor. Duke inkurajuar, mbështetur dhe koordinuar nismat pro bono, efektet e padëshiruara të reformës në drejtësi dhe defektet e zakonshme të sistemit gjyqësor, për shkak të të cilave edhe vetë avokatët vuajnë pasojat, mund të tejkalohen më lehtë kur edhe individët vulnerabël bien dakord të adresojnë çështjet e tyre në gjykatë, duke shërbyer edhe si “klientë pro bono”.



Ndihmë juridike falas

DISA IDE NGA PRAKTIKA



Ndihmë juridike

www.respublica.org.al

Formularë të thjeshtë të gatshëm



Ne ju dëgjojmë dhe ju orientojmë.

***Res Publica mund të kontaktohet
në mënyrat e mëposhtme:***

**Zyra
operative**

Blv. Gjergj Fishta, Nd. 24, H.3,
Ap.7, Tiranë

Tel:

069 21 04 804

Email:

qendra.respublica@gmail.com

web 1:

www.respublica.org.al

web 2:

www.publeaks.al